




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 30.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. **30.05.2023** të parashtruar nga: “**SPB CONSTRUCTION Sh.p.k. & Bujar Shabani B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Asfaltimi i rrugëve në komunën e Gjiilanit - Lot 1 deri ne Lot 4**”, me nr. identifikues **651-23-1153-5-1-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651-23-016-511** nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** – kërkesa për ri-shqyrtim të “**Grup i Operatorëve Ekonomik SBP CONSTRUCTION SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Asfaltimi i rrugëve në komunën e Gjiilanit - Lot 1 deri ne Lot 4**”, me nr. identifikues **651-23-1153-5-1-1** dhe numër të brendshëm i prokurimit: **GL 651-23-016-511** të datës **23.05.2023** kundër Njoftimit të **AK dhe Letrave Standarde** - të datës **19.05.2023** të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. **AK - Komuna e Gjiilanit** vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit të **AK dhe Letrave Standarde** të datës **19.05.2023**.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### A r s y e t i m

“ **SPB CONSTRUCTION Sh.p.k. & Bujar Shabani B.I.** ” me datë **23.05.2023**, kanë parashtruar kërkesat e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Asfaltimi i rrugëve në**

**komunën e Gjilanit - Lot 1 deri ne Lot 4 “ me nr.identifikues 651-23-1153-S-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651-23-016-511.** Autoriteti Kontraktues me datë 30.05.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga “ **SPB CONSTRUCTION Sh.p.k. & Bujar Shabani B.I.** ” ,Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara në lidhje me pretendimet e juaja :

**Pretendimi ankimor i parë :**

- 1. Neni 1 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së Nr. 02/L-042. neni 4.3 i Rregullave për Prokurim Publik;*
- 2. Neni 56 paragrafi 1, nëparagrafi 1 dhe 2 si dhe paragrafi 3 i LPP-së lidhur me nenin 40.12 të RRPP Nr.001/2022.*
- 3. Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së lidhur me nenin 4.3, nenin 40.1 dhe nenin 40.6 të RRPP Nr.001/2022*
- 4. Neni 60 par.1.2 i LPP-së Nr. 02/L-042 lidhur me nenin 40.13 të RRPP Nr.001/2022*

**Prandaj, për të gjitha këto arsye të cilat janë të bazuara në faktet e paraqitura më lartë si dhe të mbështetura në dispozitat ligjore të referuara më lartë, tuedneri jonë është diskualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme duke u bazuar në vlerësim të gabuar të gjendjes faktike dhe juridike, respektivisht keqinterpretim dhe aplikim të gabueshëm të dispozitave ligjore materiale dhe jo materiale.**

**Në këtë mënyrë nga ana e AK-së, vlerësimi i tenderit tonë është bërë duke i shkelur thelbësisht dispozitat e legjislacionit material të prokurimit, duke nisur nga neni e nenit 59.4, neni 56 par. 1, nënparagrafi 1 dhe 2, neni 60 par.1.2 i LPP-së të lidhura me dispozitat e legjislacionit sekondar nga neni 4.3, neni 40 par. 1, 6, 12 dhe 13 i RRPP Nr.001/2022**

**Përgjigjja rreth Pretendimit ankimor të parë :**

*Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.*

*Gjithashtu, Kërkesat për rishqyrtim jashtë afatit ligjor të paraparë me LPP-së si dhe RROUPP-së ne si AK – Autoritet Kontraktues nuk i rishqyrtojmë.*

*Rrjedhimisht, AK – Autoriteti Kontraktues qëndron mbrapa Njoftimit të AK dhe Letrave Standarde të datës 19.05.2023*

Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Shqipe Hoxha



---

Menaxhere e zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.